



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

**RAPORT
I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT
PËR VITIN 2025**

Prill 2026

2025


IV. GARANTIMI INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE

Prokuroria e Përgjithshme ka zbatuar detyrimet e saj në përputhje me ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe Vendimin e Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si më poshtë vijon:

1. Gjatë vitit 2025, janë regjistruar 73 (shtatëdhjetë e tre) kërkesa për verifikimin e të dhënave të formularëve të vetëdeklarimit të 84 (tetëdhjetë e katër) personave, subjekt të ligjit nr. 138/2015, që u përkasin organeve kompetente si më poshtë:

- 55 (pesëdhjetë e pesë) kërkesa Departamentit të Administratës Publike, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 55 (pesëdhjetë e pesë) persona të emëruar në funksione publike;
- 17 (shtatëmbëdhjetë) kërkesa Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 14 (shtatëmbëdhjetë) persona të zgjedhur ose kandidat për t’u zgjedhur;
- 1 (një) kërkesë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 12 (dymbëdhjetë) persona, kandidatë për t’u emëruar në funksione të larta publike.

(Më poshtë paraqitja grafike)



1.1 Nga 73 (shtatëdhjetë e tre) kërkesat e regjistruara në vitin 2025, 65 (gjashtëdhjetë e pesë) prej tyre janë pranuar për kryerjen e procedurës së verifikimit të thelluar të të dhënave të formularit të vetëdeklarimit nga 65 (gjashtëdhjetë e pesë) persona, të cilët e kanë plotësuar atë sipas nenit 5 të ligjit.

Kërkesat e pranuar në vitin 2025, për vazhdimin e procedurës së verifikimit, iu përkasin organeve kompetente si më poshtë:


- Departamentit të Administratës Publike, për 48 (dyzetë e tetë) persona që kanë plotësuar formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit;

- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për 17 (shtatëmbëdhjetë) persona që kanë plotësuar formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit;

Referuar nivelit hiarkik të funksioneve publike që ushtrohen nga personat e emëruar apo zgjedhur, të cilët kanë plotësuar formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit, kërkesat e pranuar në vitin 2025, për kryerjen e procedurës së verifikimit, rezultojnë si më poshtë për:

- 17 (shtatëmbëdhjetë) persona, “zyrtar i lartë” ;
- 11 (pesëmbëdhjetë) persona, “nivel drejtues”;
- 19 (nëntëmbëdhjetë) persona, “nivel i mesëm drejtues”;
- 18 (tetëmbëdhjetë) persona, “nivel ekzekutiv”;

(Më poshtë paraqitja grafike)



1.2 Ndërsa, për 8 (tetë) kërkesa, të regjistruara në vitin 2025, me të cilat është kërkuar verifikimi i të dhënave të formularit të vetëdeklarimit të 19 (nëntëmbëdhjetë) personave, është vendosur mospranimi i tyre, për shkak të mungesës së kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në pikat 1, 4 e 9 të nenit 8 dhe nenin 7 të ligjit nr. 138/ 2015, si dhe në pikat 1, 2/c, 3/b-ii, 3/ç dhe 4 të Kreut V-së të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të të cilave Prokuroria e Përgjithshme detyrohet të kryejë kontrollin e thelluar, për të verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të pasqyruara në formularin e vetëdeklarimit dhe për të konstatuar nëse rrethanat janë të ndryshme dhe se personi është subjekt i ndalimeve sipas këtij ligji.

Për personat e mësipërm, për të cilët është kërkuar verifikimi i të dhënave të vetëdeklaruar në formular sipas këtij ligji, organi kompetent, pra pala kërkuese dhe pas njoftimit me shkrim nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk plotësoi të metat brenda afatit të caktuar.

Këto kërkesa, për verifikim të të dhënave sipas këtij ligji, iu përkasin organeve kompetente si më poshtë vijon:

- Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 1, për formularët e vetëdeklarimit të plotësuar nga 12 (dymbëdhjetë) persona, kandidatë për anëtarë në Gjykatën Kushtetuese;

- Departamentit të Administratës Publike 7, për formularët e vetëdeklarimit të plotësuar nga 7 (shtatë) persona të emëruar në funksione publike.

Referuar nivelit hiarkik të funksioneve publike që ushtrohen nga personat e emëruar ose zgjedhur, nuk është pranuar kërkesa për verifikim e bërë, nga organet kompetente, gjatë vitit 2025, si më poshtë për:

- 12 (dymbëdhjetë) persona, “zyrtar i lartë” ;
- 2 (dy) persona, “nivel drejtues”;
- 3 (tre) persona, “nivel i mesëm drejtues”;
- 2 (dy) persona, “nivel ekzekutiv”.

2. Në Sektorin e Dekriminalizimit gjatë vitit 2025, nga organet kompetente janë paraqitur, depozituar, dhe 2 (dy) kërkesa, për verifikimin e të dhënave sipas ligjit nr. 135/2015, për 14 (katëmbëdhjetë) persona, të cilat janë *quajtur të pa regjistruara e të kthyera*, për shkak të mungesës së kompetencës për kërkimin dhe kryerjen e verifikimit të thelluar të të dhënave nga Prokuroria e Përgjithshme, në zbatim të nenit 5, në nenit 6, nenit 7 dhe pikave 1, 4 e 9 të nenit 8 të ligjit nr. 138/2015, si dhe në Kreun II, III e V-së të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.


Sipas organeve kompetente që kanë kërkuar shqyrtimin dhe verifikimin e të dhënave sipas këtij ligji, kërkesat u përkasin si vijon më poshtë:

- Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë, për trembëdhjetë 13 persona, kandidatë jo magjistratë për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, funksion publik i “nivelit të lartë”.
- Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për një 1 kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, funksion publik i “nivelit të lartë”.

3. Për vitin 2025, Sektori i Dekriminalizimit ka kryer 121 (njëqind e njëzetë e një) procese të verifikimit të thelluar të të dhënave në zbatim të ligjit nr. 138/2015, sipas kërkesave të pranuar për:

- 65 (gjatëdhjetë e pesë) persona, në vitin 2025;
- 25 (njëzet e pesë) persona, në vitin 2024;
- 17 (shtatëmbëdhjetë) persona, në vitin 2023;
- 1 (një) person, në vitin 2022;
- 6 (gjashtë) persona, në vitin 2021;
- 3 (tre) persona, në vitin 2020;
- 3 (tre) persona, në vitin 2019;
- 1 (një) persona, në vitin 2017.


(Më poshtë paraqitja grafike)



Sipas organeve kompetente që kanë paraqitur kërkesat, këto procese u përkasin, si më poshtë vijon:

- Departamentit të Administratës Publike, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 76 (shtatëdhjetë e gjashtë) persona;
- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 42 (dyzetë e dy) persona;
- Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 1 (një) person;
- Ministrisë së Brendshme për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 1 (një) person;
- Këshillit të Lartë Gjyqësor për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 1 (një) person.


(Më poshtë paraqitja grafike)



4. Gjatë vitit 2025, nga kërkesat e mësipërme, ky sektor ka përfunduar procesin e verifikimit dhe miratuar rezultatet për 77 (shtatëdhjetë e shtatë) persona/subjekte të ligjit, nga të cilët:

- 44 (dyzetë e katër) subjekte u përkasin proceseve të regjistruara në vitin 2025;
- 19 (nëntëmbëdhjetë) subjekte u përkasin proceseve të regjistruara në vitin 2024;
- 7 (shtatë) subjekte u përkasin proceseve të regjistruara në vitin 2023;
- 1 (një) subjekt i përket procesit të regjistruar në vitin 2022;
- 4 (katër) subjekte u përkasin proceseve të regjistruara në vitin 2021;
- 2 (dy) subjekte u përkasin proceseve të regjistruara në vitin 2020.


(Më poshtë paraqitja grafike)



Këto procese verifikimi, sipas organeve kompetente që kanë paraqitur kërkesat u përkasin, si më poshtë vijon:

- Departamentit të Administratës Publike, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 59 (pesëdhjetë e nëntë) persona/subjekte të ligjit;
- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 17 (shtatëmbëdhjetë) persona/subjekte të ligjit;
- Komisionit të Pavaruar të Kualifikimit, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 1 (një) person/subjekt i ligjit.

(Më poshtë paraqitja grafike)




4.1 Nga 65 (gjashtëdhjetë e pesë) kërkesat e pranuar e regjistruara në vitin 2025, Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme ka përfunduar procesin e verifikimit të thelluar dhe miratuar rezultatin për 44 (dyzetë e katër) persona/subjekte të ligjit, dhe ka vijuar për vitin 2026 procesin e verifikimit për 21 (njëzetë e një) persona/subjekte të ligjit.

Sipas organeve kompetente që kanë kërkuar, në vitin 2025, verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formularë në zbatim të ligjit nr. 138/2015, gjendja e proceseve është si më poshtë vijon:

		Të përfunduara	Në Proces
1.	Departamenti i Administratës Publike	38	10
2.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	6	11
	TOTALI	44	21


(Më poshtë paraqitja grafike)



Proceset e verifikimit të regjistruara në bazë të kërkesave të pranuar për vitin 2025 dhe që kanë përfunduar brenda vitit 2025, sipas nivelit hierarkik të funksioneve publike që ushtrohen nga personat e emëruar ose që zgjidhen, u përkasin si më poshtë:

- 6 (gjashtë) personave, “zyrtar i lartë”;
- 7 (shtatë) personave, “nivel drejtues”;
- 15 (pesëmbëdhjetë) personave, “nivel ekzekutiv”;
- 16 (gjashtëmbëdhjetë) personave, “nivel i mesëm drejtues”.


(Më poshtë paraqitja grafike)



Ndërsa, proceset e verifikimit të regjistruara në bazë të kërkesave të pranuar për vitin 2025 dhe që nuk janë përfunduar brenda vitit 2025, referuar nivelit hierarkik të funksioneve publike që ushtrohen nga personat e emëruar ose zgjidhur, u përkasin si vijon:

- 11 (njëmbëdhjetë) personave, “zyrtar i lartë” ;
- 4 (katër) personave, “nivel ekzekutiv”;
- 3 (tre) personave, “nivel drejtues”;
- 3 (tre) personave, “nivel i mesëm drejtues”.

(Më poshtë paraqitja grafike)



➤ Departamenti i Administratës Publike, pas njoftimit nga Prokuroria e Përgjithshme të rezultateve të verifikimit për 38 (tridhjetë e tetë) persona subjekt të ligjit, si organ përgjegjës për zbatimin e ndalimeve, në vitin 2025 ka bërë me dije qëndrimet për 35 (tridhjetë e pesë) prej tyre, si vijon:

- 4 (katër) persona/subjekte janë “liruar nga detyra”;
- 1 (një) person/subjekt është “dorëhequr”;
- 3 (tre) person/subjekte janë “liruar nga shërbimi civil”;
- 1 (një) person/subjekt “ka kërkuar të shkëpusë marrëdhëniet e punës”;
- 1 (një) person/subjekt është larguar/”zgjidhur marrëdhënia e punës për shkaqe të justifikuara”;
- 2 (dy) persona/subjekte iu “ka përfunduar periudha e ndalimit”;
- 23 (njëzetë e tre) persona/subjekte “nuk përfshihen brenda sferës apo periudhës së ndalimeve”.


Për 10 (dhjetë) persona/subjekte të ligjit, organet kompetente nuk kanë bërë me dije qëndrimet e tyre ndaj këtyre subjekteve në bazë të rezultateve të miratuara pas procesit të verifikimit të të dhënave nga ky sektor. Këto u përkasin:

- Departamentit të Administratës Publike, për 4 (katër) persona/subjekte të ligjit;
- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për 6 (gjashtë) persona/subjekte të ligjit.

4.2 Nga 56 (pesëdhjetë e gjashtë) kërkesat e pranuar dhe të regjistruara në vitet 2017-2024, brenda vitit 2025 ka përfunduar procesi i verifikimit të thelluar dhe është miratuar rezultati për 33 (tridhjetë e tre) subjekte të ligjit dhe ka vazhduar për vitin 2026 procesi i verifikimit për 23 (njëzetë e tre) subjekte të ligjit.

		Të përfunduara	Në Proces
1.	Departamenti i Administratës Publike	21	7
2.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	11	14
3.	Këshilli i Lartë Gjyqësor	0	1
4.	Ministria e Brendshme	0	1
5.	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit	1	0
		33	23


(Më poshtë paraqitja grafike)



Referuar nivelit hierarkik të funksioneve publike që ushtrohen nga 33 (tridhjetë e tre) subjektet që u përkasin proceseve të verifikimit, të regjistruar në vitet 2017 – 2024, dhe përfunduara brenda vitit 2025, rezultojnë si më poshtë:

- 6 (gjashtë) persona, “zyrtar i lartë” ;
- 11 (njëmbëdhjetë) persona, “nivel drejtues”;
- 4 (katër) persona, “nivel i mesëm drejtues”;
- 12 (dymbëdhjetë) persona, “nivel ekzekutiv”.

(Më poshtë paraqitja grafike)



➤ Pas njoftimit të rezultateve të verifikimit të të dhënave të vetëdeklaruar në formular sipas ligjit, nga 33 (tridhjetë e tre) personat e sipërcituar, Departamenti i Administratës Publike, si organ

përgjegjës për zbatimin e ndalimeve, brenda vitit 2025, ka bërë me dije qëndrimet për 21 (njëzetë e një) prej tyre si vijon:

- 4 (katër) persona/subjekte janë “liruar nga shërbimi civil”;
- 17 (shtatëmbëdhjetë) persona/subjekte “nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve”;

Gjatë vitit 2025, nuk rezulton të ketë informacion për qëndrimin e mbajtur pas shyrtimit të rezultateve të miratuara nga procesi i verifikimit të kryer, nga:


- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për 11 (njëmbëdhjetë) persona/ subjekt të ligjit.
- Komisioni i Pavaruar i Kualifikimit, për 1 (një) person/subjekt i ligjit.

5. Nga rastet e mësipërme, mbështetur në nenet 69, 74 e 76 si dhe nenin 293 të Kodit të Procedurës Penale, materiali është referuar në prokuroritë përkatëse, ndaj 20 (njëzetë) personave, si të dyshuar për veprën penale “Falsifikim i vulave, i stampave ose i formularëve” të parashikuar nga neni 190 i Kodit Penal.

Subjektet e ligjit, pra, personat ndaj të cilëve është referuar vepra penale tek prokuroria përkatëse, u përkasin organeve kompetente që kanë kërkuar verifikimin si më poshtë vijon:

- 14 (katërmëdhjetë) persona/subjekte, Departamentit të Administratës Publike;
- 6 (gjashtë) persona/subjekte, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.


(Më poshtë paraqitja grafike)



Personat që kanë rezultuar të kenë plotësuar formularin e vetëdeklarimit me të dhëna të rreme, sipas nivelit hierarkik të funksioneve publike që ushtrojnë, rezultojnë të jenë:

- 1 (një) është “zyrtar i lartë”;
- 6 (gjashtë) janë “nivel drejtues”;
- 6 (gjashtë) janë “nivel i mesëm drejtues”.
- 3 (tre) janë “nivel ekzekutiv”.


(Më poshtë paraqitja grafike)



5. Në vitin 2026, vijojnë të jenë në proces verifikimi gjithësej 44 (dyzetë e katër) persona, subjekte të ligjit, të cilët sipas vitit të regjistrimit dhe pranimit të kërkesës, rezultojnë si më poshtë:

- 21 (njëzetë e një) persona/subjekte, të vitit 2025;
- 6 (gjashtë) persona/subjekte të vitit 2024;
- 10 (dhjetë) persona/subjekte të vitit 2023;
- 2 (dy) persona/subjekte të vitit 2021;
- 1 (një) person/subjekt i vitit 2020;
- 3 (tre) persona/subjekte të vitit 2019;
- 1 (një) persona/subjekte të vitit 2017.


(Më poshtë paraqitja grafike)



Sipas institucioneve kompetente që kanë paraqitur kërkesat, këto procese verifikimi u përkasin si më poshtë vijon:

- Departamentit të Administratës Publike, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 17 (shtatëmbëdhjetë) persona të emëruar në funksione publike;
- Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 25 (njëzetë e pesë) persona të zgjedhur;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 1 (një) person;
- Ministria e Brendshme për verifikimin e të dhënave të vetëdeklaruar në formular nga 1 (një) person.

(Më poshtë paraqitja grafike)



Referuar nivelit hiarkik të funksioneve publike që ushtrohen nga personat e emëruar ose që zgjidhen, këto procese verifikimi u përkasin:

- 19 (nëntëmbëdhjetë) persona, “zyrtar i lartë” ;
- 11 (njëmbëdhjetë) persona, “nivel drejtues”;
- 7 (shtatë) persona, “nivel i mesëm drejtues”;
- 7 (shtatë) persona, “nivel ekzekutiv”.

6. Në zbatim të pikës 9, të Kreut II, të Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, brenda muajit mars të vitit 2025, vetëm, Sektori i Integritetit dhe Mbikëqyrjes, në Drejtorinë e Integritetit, Mbikëqyrjes dhe Ankesave Administrative Gjyqësore, në Departamentin e Administratës Publike dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, si organ përgjegjës për administrimin e formularit të vetëdeklarimit dhe për zbatimin e ndalimeve, kanë informuar Prokurorin e Përgjithshëm, për numrin e personave që kanë rezultuar në kushtet e ndalimit, apo që nuk kanë dorëzuar formularin e vetëdeklarimit.

Gjatë vitit 2025, Sektori i është përgjigjur në kohë kërkesave të këtyre organeve përgjegjëse dhe palëve të tjera në proces, për statusin e procesit të verifikimit të thelluar dhe interpretime të ndryshme ligjore në lidhje me rezultatet e verifikimit të miratuara me vendim dhe zbatimin e ligjit nr. 138/2015 dhe Vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.